


REPUBLICA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE KORÇË

Nr. 1665 REP.

Nr. 1023 KOL.



KONTRATË PJESTIMI
Të Veprimtarisë Ekonomike të Shoqërisë

Sot në Korçë, më datë 19.12.2012, përpara meje Noterit Agron Azisllari, anëtar i Dhomës së Noterëve Korçë, u paraqiten personalisht palët e mëposhtme me përfaqësuesit e tyre respektivë si më poshtë:

KALUESI: Shoqëria Tregtare "MERMER BALLIU" SHPK, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me Nr. K23801002R NIPTI, me seli në adresën: Rruga Nacionale Korçe - Maliq, Km I, Prane Ures, Objekt Privat, Bulgarec/ KORÇË, përfaqësuar nga ortaku, z.JORGJI BALLIU, i biri i THOMAIT, i datëlindjes 27.09.1956, mbajtës i leternjoftimit 029530868, i cili merr pjesë në këtë kontratë në cilësinë e "KALUESIT TË VEPRIMTARISË" ose shkurt "KALUESI";

MARRËSI: Shoqëria Tregtare "PRINC BALLIU" SHPK, person juridik shqiptar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me NIPT L24602002T, me seli në Adresën: Rruga Muzakaj, Autostrada Korçe - Maliq, Km I Korçë, përfaqësuar nga ortaku, z.PETRAQ THOMA BALLIU, i datëlindjes 02.03.1962, i biri i THOMAIT, mbajtës i leternjoftimit 027972752, i cili merr pjesë në këtë kontratë në cilësinë e "MARRËSIT TË VEPRIMTARISË" ose shkurt "MARRËSI".

Kjo kontratë hartohet në bazë të dispozitave përkatëse të Kodit Civil në Republikën e Shqipërisë, Ligjit Nr. 7928 datë 27.04.1995 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar" (i ndryshuar) dhe Udhëzimin Nr. 17 datë 13.05.2008 të Ministrisë të Financave "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar" (i ndryshuar).

Përfaqësuesit e subjekteve tregtare të sipërcituara, janë të gjithë madhorë, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilëve u sigurova nga dokumentet identifikuese që ata më paraqitën. Ata kanë rënë dakord që të lidhin këtë Kontratë me përmbajtje si më poshtë vijon:

1. KUSHTET PARAPRAKE


- 1.1 KALUESI, është person juridik shqiptar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të regjistrimit me NIPT K23801002R, me Ortakë të saj, z. Jorgji BALLIU i cili zotëron 50 % të kuotave dhe z. Petraq BALLIU i cili zotëron 50 % të kuotave.
- 1.2 KALUESI ushtron veprimtarinë e tij ekonomike në qytetin e Korçës, përkatësisht në Adresën: Rruga Nacionale Korçe - Maliq, Km I, Prane Ures, Objekt Privat, Bulgarec/ KORÇË”.
- 1.3 KALUESI ndër të tjera ushtron dhe aktivitetin e saj veprimtarise te importit te materialeve te ndertimit në qytetin e Korçës.
- 1.4 MARRËSI, person juridik shqiptar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me NIPT L24602002T, me seli në Adresën: Rruga Muzakaj, Autostrada Korçe - Maliq, Km I-rë Korçë.
- 1.5 MARRËSI ka si objekt të veprimtarisë së saj: Perpunim mermer guri, prerje te mermerit artistik. Import - eksport te mallrave hidrosanitare, materiale ndertimi, elektro shtepiake, mallrave industriale dhe ushqimore, etj. Ortak i vetëm i kësaj shoqërie është z. Petraq Balliu i cili zotëron 100 % të kuotave të kapitalit themeltar.
- 1.6 MARRËSI është e interesuar të marrë aktivitetin ekonomik të veprimtarise te importit te materialeve te ndertimit, që Pala e Parë ushtron në qytetin e Korçës.
- 1.7 Veprimtaria ekonomike e veprimtarisë së importit të materialeve të ndërtimit që Kaluesi ushtron në qytetin e Korçës, ka autonomi ekonomike, pra ka mundësi të funksionojë si e pavarur, duke plotësuar të gjitha kushtet për kryerjen e veprimtarisë ekonomike (ambientet, makineritë, mjetet, burimet njerëzore etj..)
- 1.8 Asambleja e Ortakëve të Kaluesit, me Vendimin Nr. 04 datë 10.11.2012 ndër të tjera ka vendosur:

i. Transferimi i Veprimtarisë së importit të materialeve të ndërtimit që të transferojë aktivitetin e saj ekonomik të importit te materialeve te ndertimit, që Pala e Parë ushtron në qytetin e Korçës, tek Shoqëria Tregtare “Princ Balliu” SHPK me NIPT L24602002T, duke respektuar dispozitat përkatëse të nenit 12 të Ligjit Nr. 7928 datë 27.04.1995 “Për tatimin Mbi Vlerën e Shtuar”, Udhëzimit Nr. 17 datë 13.05.2008 i Ministrisë të Financave “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” (i Ndryshuar) dhe nenet 138 dhe 139 të Kodit të Punës

- 1.9 Marrësi, me Vendim të Ortakut të Vetëm Nr. 01 datë 31.10.2012 ndër të tjera, ka vendosur:

i. Pranimin e transferimit të veprimtarisë së importit të materialeve të ndërtimit që aktualisht zotërohet (ushtrohet) nga shoqëria “MERMER BALLIU” SHPK, nga Shoqëria Tregtare “Mermer Balliu” SHPK tek Shoqëria Tregtare “PRINC BALLIU” SHPK.

ii. Transferimi i veprimtarisë ekonomike të kryhet në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 12 “Transferimi i veprimtarisë ekonomike”, të Ligjit Nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për Tatimin mbi Vlerën



e Shtuar", i ndryshuar dhe në pikën 4 "Transferimi i veprimtarisë ekonomike", të Udhëzimit Nr.17, datë 13.05.2008 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar", i ndryshuar;

- 1.10 Palët deklarojnë se në datën 04.12.2012 kanë nënshkruar Marrëveshjen Paraprake për transferimin e veprimtarisë së importit të materialeve të ndërtimit që aktualisht zotërohet (ushtrohet) nga shoqëria "MERMER BALLIU" SHPK, tek Shoqëria Tregtare "PRINC BALLIU" SHPK. Me anë të kësaj marrëveshje, palët kanë marrë përsipër angazhimet që të plotësojnë të gjitha kriteret përkatëse të përmendura në legjislacionin shqiptar në fuqi, në mënyrë që të bëhej i mundur transferimi.
- 1.11 Palët me anë të Marrëveshjes Paraprake, kanë rënë dakord që pas përfundimit të të gjitha procedurave përkatëse të transferimit të veprimtarisë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, të nënshkruajnë Kontratën Përfundimtare të transferimit të veprimtarisë.
- 1.12 Palët deklarojnë se ky akt është kontrata përfundimtare e transferimit të veprimtarisë;
- 1.13 Palët me vullnetin e tyre të lirë deklarojnë se janë plotësuar të gjitha kriteret ekonomike dhe ligjore për të bërë të mundur transferimin e veprimtarisë.

2. TRANSFERIMI

- 2.1 KALUESI transferon të gjithë veprimtarinë e tij tregtare së importit të materialeve të ndërtimit që aktualisht zotëron (ushtrohen), tek MARRËSI sipas kushteve dhe kriterëve të përmendura në këtë kontratë, në Ligjin Nr. 7928 datë 27.04.1995 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar" (i ndryshuar) dhe Udhëzimin Nr. 17 datë 13.05.2008 të Ministrit të Financave "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar" (i ndryshuar).
- 2.2 MARRESI, është dakord që veprimtaria e sipërpërmendur, e cila ushtrohet nga KALUESI në qytetin e, t'i transferohet atij, duke u bërë ai vetë zotëruar i drejtpërdrejtë i saj.

3. KUSHTI LIGJOR DHE EKONOMIK

- 3.1 Veprimtaria që ushtron KALUESI dhe që transferohet, plotëson kushtin ekonomik sipas kriterëve të nenit 12 të Ligjit Nr. 7928 datë 27.04.1995 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar" dhe pikës 4 të Udhëzimit Nr. 17 datë



13.05.2008 të Ministrit të Financave "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar". Pikërisht në lidhje me kushtin ekonomik, kjo veprimtari që ushtrohet nga KALUESI, ka një autonomi ekonomike, pasi i ka të gjitha kushtet e mjetet për realizimin e veprimtarisë së saj. Mjetet dhe kushtet që vetë KALUESI ka për ushtrimin e aktivitetit të tij, janë bashkëngjitur kësaj kontrate.

3.2 Veprimtaria që ushtron KALUESI dhe që do të transferohet, plotëson kushtin ligjor. Në bazë të Legjislacionit në fuqi, janë bërë të gjitha verifikimet dhe se cilat asete që përdoren janë verifikuar sa dhe cilat asete të aktivitetit përdoren për prodhimin e produktit dhe sa janë transferuar dhe po kështu në pasiv, sa të ardhura janë realizuar për shkak të këtij kalimi. Të njëjtat verifikime janë bërë në bilancin e MARRESIT, sa asete kanë hyrë dhe çfarë veprimesh janë bërë në pasiv.

3.3 Palët deklarojnë se janë njohur me Raportin E Ekspertit Kontabël të Regjistruar znj. Anila CUNOTI si dhe aktet e tjera përkatëse ndodhen bashkëngjitur kësaj kontrate dhe janë pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

3.4 Në kuadrin e këtij transferimi është parashikuar që KALUESI t'i transferojë MARRËSIT nga tërësia e elementeve të aktivitetit dhe pasivit të Pasqyrave Financiare të datës 30.09.2012, kryesisht tokë sipas raportit të topografit Jorgo Saro (bashkëngjitur kësaj kontrate), ndërtesa, makineri, ortake, furnitore dhe kapital.

3.5 Transferimi i këtyre zërave bëhet sipas inventarit analitik i cili shoqëron dhe këtë raport të Ekspertit Kontabël të Regjistruar, bashkëngjitur kësaj kontrate.

3.6 Palët të dy së bashku, deklarojnë se është përmbushur kushti ligjor dhe ekonomik sipas të dhënave të bashkëngjitura në këtë kontratë dhe se ndaj tyre nuk kanë ndonjë kundërshtim dhe se i pranojnë dhe i dinë pasojat që vijnë prej tyre.

4. VLERA E KËMBIMIT

4.1 Vlera totale e këmbimit për efekt të këtij transferimi, është në shumën prej 50.290.526 Leke .

4.2 Vlera e kapitalit të nënshkruar që transferohet është në shumën prej 32.590.000 Leke.

4.3 Vlerat e mësipërme, vërtetohen sipas bilanceve dhe aktit të ekspertimit kontabël të Ekspertes znj. Anila CUNOTI bashkëngjitur kësaj kontrate.



5. KËMBIMI I VLERËS SË TRANSFERIMIT

5.1 Ky transferim është kryer sipas këmbimit të përmendur në pikën 4.1 jashtë zyrës së noterit, dhe palët deklarojnë se janë dakord me këtë këmbim dhe nuk paraqesin pretendime.

6. KALIMI I PRONËSISË SË VEPRIMTARISË

6.1 Kjo Kontratë i fillon efektet e saj duke filluar nga data 19.12.2012, për këtë arsye, pronësia e veprimtarisë konsiderohet e kaluar në favor të MARRËSIT, në datën 19.12.2012.-----

6.2 Duke filluar nga data 19.12.2012, MARRËSI fillon administrimin e veprimtarisë së përmendur në këtë Kontratë.

6.3 KALUESI duke filluar që nga data 19.12.2012 humbet çdo të drejtë mbi veprimtarinë e përmendur në këtë Kontratë.

7. KALIMI (TRANSFERIMI) I PRONËSISË SË PASURIVE TË PALUAJTËSHME

7.1 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Pasuria e ndodhur në zonën 8561 me Nr. 4/795, Vol 43, fq 59, që në aktin e ekspertimit të ekspertit Ing. Jorgo SARO përmendet me gërmën "B" (PJESA "B"), me sipërfaqe 1395 m2 së bashku me sipërfaqen ndërtimore prej 420.8 m2, së bashku me ndërtesën e ndodhur mbi të.-----


7.2 Pasurija me Nr. 119/2, zona kadastrale 1310, volumi 8 ,faqe 8 me sipërfaqe 2769 m2.----

7.3 Pasurija me Nr.120/9, zona kadastrale 1310, volumi 9, faqe 235 ,me sipërfaqe 1260 m2, i kalon në pronësi MARRËSIT.-----

7.4 KALUESI është dakord me këtë kalim të pronësisë, dhe është në dijeni të faktit se me nënshkrimin e kësaj kontrate, nuk do të jetë më pronar i pasurisë së përmendur në pikën 7.1 të këtij neni.

8. TË TJERA

8.1 Pjesë përbërëse dhe e pandarë të kësaj Kontrate janë edhe dokumentet e mëposhtme:



- 1- Kontrata Paraprake e datës 18.12 2012, e lidhur midis palëve të kësaj kontrate;
- 2- Vendime të Asamblese së Ortakeve të të dy palëve të kësaj kontrate
- 3- Raporti Ekspertit Kontabel të regjistruar znj. Anila CUNOTI;
- 4- Raporti i Ekspertit Topograf z. Jorgo Saro;
- 5- Aktet e pronësive së pasurisë që transferohet;
- 6- Bilancet e të dy palëve të kësaj kontrate

Kjo kontratë hartohet në 7 (shtatë) kopje me vlerë të njëjtë, ndër të cilat, një kopje mbahet në zyrën e notarisë, ndërsa të tjerat ndahen ndërmjet palëve. Marrësi merr përsipër që një kopje të kësaj kontrate t'ua dërgojë institucioneve përkatëse.

Pasi unë Noteri ua lexova me zë të lartë palëve tekstin e kësaj Kontrate, të cilët më deklaruan se e kuptojnë, pranojnë dhe se është hartuar në përputhje të plotë me vullnetin e tyre të lirë, e vërtetoj këtë sipas ligjit.

PALËT

KALUESI

Shoqëria Tregtare
"Mermer Balliu" SHPK
Përfaqësuar nga
JORGJI BALLIU

Jorgji Balliu
[Signature]

MARRËSI

Shoqëria Tregtare
"Princ Balliu" SHPK
Përfaqësuar nga
PETRAQ BALLIU

Petraq Balliu
[Signature]

NOTERI: AGRON AZISLLARI

[Signature]

